



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prilato Received/Delivered	04.09.2023	3	viti god. year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSICK	5945/2023		1/7



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.1019/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Jeton Koca, anëtarë; me Sabile Avdyli, zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, si procesmbajtëse, sipas ankesës me numër A.nr.1019/2023, të datës 21.07.2023, të parashtruar nga ankuesi [redacted] nga Rahoveci, kundër organit të punësimit: Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, në çështjen juridike "*kontestim konkursi*", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 04.09.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1019/2023, e datës 21.07.2023, e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Anullohet** Vendimi Nr.15/2023, i datës 19.07.2023 dhe Vendimi Nr.14/2023, i datës 10.07.2023, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.
- III. Obligohet** Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi, të përshijë ankuesin [redacted] në listën e ngushtë/të kandidatëve, që kanë plotësuar kushtet për Konkursin me numër reference RN00011612, për emrin e grupit "*Specialistë të Arsimit*" lidhur me vendin e punës "*Inspektor i Arsimit*" SIA Gjakovë.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesi, [REDAKTUAR], (me tej referuar ankuesi), me datë 21.07.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.1019/2023, kundër Vendimit me Nr.15/2023 të datës 19.07.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me pretendimin se Konkursi me numër të referencës RN00011612, për grupin "Specialist i Arsimit", është përcjell me shkelje të vazhdueshëm të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin e Karrierës në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.07.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit, me datë 01.08.2023, ka përcjell shkresat referuar çështjes në shqyrtim dhe vendosje

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5323/2023 të datës 21.07.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 12.07.2023 të parashtruar nga ankuesi për Ministrinë e Punëve të Brendshme/DMZP; Vendimin me Nr.14/2023 të datës 10.07.2023, të DMZP; Vendimin me Nr.15/2023 i datës 19.07.2023 i DMZP; Licencën e mësimdhënësit me nr.100008174, të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për ankuesin, Kopja e konkursit me nr. reference RN00011612; Vërtetimin me nr.ref.nr.368/23 i datës 26.05.2023 i lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Komunën e Rahovecit; CV e ankuesit; Certifikatën me Nr.189/112, e datës 20.04.2012 e lëshuar nga Fakulteti Filozofik në Universitetin e Prishtinës për ankuesin, për përfundim të studimeve të nivelit master; Diplomën me Nr.1813 e datës 30.06.2011 e lëshuar nga Fakulteti Filozofik në Universitetin e Prishtinës me të cilën dëshmohet se ankuesi mori titullin Profesor i Historisë; Ankesën e parashtruar nga ankuesi përmes e-malit të datës 13.07.2023 për DMZP; e-mali i datës 12.07.2023 dërgimi i vendimit për ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 27.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 01.08.2023 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës si: Aplikacioni i datës 30.05.2023 me nr. referencës së shpalljes RN00011612 për [REDAKTUAR]; Certifikatë me Nr.0207/002, e datës e datës 26-29 nëntor 2015 e lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Certifikatë e datës 01.07.2016, e lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Certifikatë për trajnim për kryetar të Arkivave Profesionale për "Sigurim të Cilësisë"; certifikatë e lëshuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës; Certifikatë me Nr.1038/003, e datës 12-15.09.2013, e lëshuar nga MASHT; certifikatë e muajit shkurt 2020, e lëshuar nga MASHT; Certifikatë Nr.133, e muajit gusht 2019, e lëshuar nga MASHT; Certifikatë Nr.5643/005, të muajit nëntor-dhjetor 2019, e lëshuar nga MASHT; Certifikatë Nr.31665/073, e datës 08.12.2020, e lëshuar nga MASHT; Certifikatë e muajit prill 2021, e lëshuar nga USAID; Certifikatë e vitit 2014, e lëshuar nga MASHT; Certifikatë Nr.32302/078, të muajit maj 2021, e lëshuar nga MASHT/KEC; Certifikatë Nr.32556/076, e datës 31.05.2021, e lëshuar nga MASHT/KEC; Certifikatë e muajit korrik 2022, e lëshuar nga MASHT/GIZ; Mirënjohje e datës 17.02.2022, për [REDAKTUAR], e lëshuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e

Rahovecit; Certifikatë e muajit dhjetor 2022, e lëshuar nga MASHT/EDUMEN-K; Certifikatë e datës 04-05.07.2020, e lëshuar nga MASHT; Certifikatë e muajit mars 2013, e lëshuar nga USAID; Certifikatë e vitit 2013, e lëshuar nga MASHT; Diploma e datës 19.12.2011, për aftësitë e liderit të pajtimit, e lëshuar nga Federata e mësuesve të Kanadës; Mirënjohje e Shoqatës së Historianëve të Kosovës dega në Rahovec; Certifikatë lëshuar nga KEDP; Certifikatë e datës 13.02.2005, e lëshuar nga MASHT/GTZ; Certifikatë e datës 29.09.2006, e lëshuar nga MASHT/GTZ; Certifikatë e datës 25.10.2002, e lëshuar nga Qendra Kosovare e të Drejtave të Fëmijëve; Certifikatë Nr.6198/026, e datës 15.12.2006, e lëshuar nga KEC; Certifikatë Nr.6625/027, të datës 15.03.2007, e lëshuar nga KEC; Certifikatë e datës 15 dhe 16 dhjetor 2007, e lëshuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë; Mirënjohje e datës 06.06.2008, e lëshuar nga Sh.F.” Hamëz Thaqi” në Xërxë; Certifikatat për punëtori për trajnimin e trajnerëve të lëshuara nga CDRSEE dhe KEC; Kontratë Pune për Mësimdhënës me Nr. Protokolli 185 e datës 22.09.2015 e lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec; Certifikatë mbi dënimet penale me nr.5661/EDFDEF1422 e datës 23.05.2023, e lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Certifikatë e vitit 2017, e lëshuar nga MASHT; Vërtetimi me Nr.32556/076 i datës 31.05.2023, i lëshuar nga MASHT/KEC; Certifikatë e muajit shkurt 2020, e lëshuar nga MASHT; Kopja e letërnjoftimit të ankuesit; Lista e aplikantëve; lista e kandidatëve të aprovuar; lista e kandidatëve të refuzuar; Vendimi për emërimin e Komisionit të Pranimit me Nr.05/151 i datës 12.07.2023 i nënshkruar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës; Njoftimi i datës 10.07.2023 për kandidatët që kanë hyr në listën e ngushtë i lëshuar nga DMZP dhe Njoftimi i datës 19.07.2023 për kandidatët që kanë hyr në listën e ngushtë i lëshuar nga DMZP.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat e marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (me tej referuar DMZP), në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 05.05.2023, ka shpallur në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), Konkursin për praninë, me numër reference RN00011612, për emrin e grupit “Specialistë të Arsimit” lidhur me vendin e punës “Inspektor i Arsimit” në SIA Gjakovë, Klasa profesional 1, numri i kërkuar tre (3) pozita.

Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 26.05.2023 deri me datën 05.06.2023, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi sipas aplikacionit me numër kodi RAN00011612, të datës 30.05.2023.

Në fazën e shqyrtimit paraprak, njësia përgjegjëse në këtë rast DMZP-ja, përmes Vendimit Nr.14/2023, të datës 10.07.2023, ka refuzuar aplikacionin e ankuesit, për shkak se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi lidhur me licencën e mësimit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës si dhe dëshmi se nuk ka në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, ashtu siç është kërkuar me konkurs.

Pas ankesës së ankuesit kundër Vendimit Nr.14/2023, të datës 10.07.2023, DMZP-ja me Vendimin Nr.15/2023, të datës 19.07.2023, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e ankuesit, duke e aprovuar pretendimin se ankuesi ka sjell dëshmi për licencën e mësimit të kualifikuar, ndërsa, konstatohet se ankuesi nuk ka sjell dëshmi se nuk ka në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik.

Ankuesi, brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshill, me pretendimet se i njëjti edhe me rastin e aplikimit dhe po ashtu edhe në ankesën e parashtruar me datë 12.07.2023 të njësia përgjegjëse, ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara sipas konkursit, përkatësisht licencën e mësimdhënies dhe vërtetimin e datës 26.05.2023 sipas së cilës konfirmohet së është në marrëdhënia të rregullt pune dhe vazhdon ta ushtroj detyrën e mësimdhënësit në Shkollën e Mesme të Lartë “Xhelal Hajda –Toni”.

Në funksion të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore referuar procedurës dhe kushteve të pranimit të nëpunësve civilë, përkatësisht:

-Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, ku me nenin 34 përcaktohet: 1. *Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, pranimi në Shërbimin Civil bëhet në kategorinë profesionale në grupin e administrimit të përgjithshëm dhe në secilin nga grupet e administrimit të veçantë.* 2. *Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe publik. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë.* 3. *Konkurrimi organizohet nga DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia e Burimeve Njerëzore për çdo institucion tjetër (në tekstin në vijim: njësia përgjegjëse).* 4. *Njoftimi për hapjen e procedurës të konkurrimit shpallet në një afat jo më të shkurtër se 21 ditë, nga data e përcaktuar për paraqitjen e aplikimit, nga njësia përgjegjëse, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme. Afati për pranimin e aplikacioneve nuk mund të jetë më i shkurtër se 8 dite dhe jo më i gjatë se 15 ditë kalendarike.* 5. *Shpallja e konkursit, sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfshin përshkrimin e përgjithshëm të punës për grupin përkatës, pozitat e punës të lira në grupin përkatës, kriteret që duhet t'i plotësojnë kandidatët, afatin për aplikim, të dhënat e hollësishme për zhvillimin e procesit të përzgjedhjes dhe dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim.* 6. *Konkurrimi zhvillohet në dy faza: 6.1. verifikimi paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; 6.2. vlerësimi i njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.* 7. *Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia e përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komisioni i pranimit (në vijim: Komisioni i pranimit), i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë për të cilin zhvillohet konkurrimi....*

-Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku neni 10 parasheh se : 1. *Shpallja e konkurimit për një Grup të caktuar përmban, të paktën, këto të dhëna: 1.1. përshkrimin e përgjithshëm të punës së Grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 1.2. Kërkesat e përgjithshme për pranim sipas nenit 8 të LZP; 1.3. kërkesat e përgjithshme formale; 1.4. njohuritë, aftësitë dhe cilësitë që vlerësohen në procedurën e konkurrimit (kërkesat e përgjithshme të nevojshme); 1.5. listën e pozitive, aktualisht të lira, të Grupit për të cilin zhvillohet konkurimi; 1.6. mënyrën për paraqitjen e aplikacioneve; 1.7. afatin përfundimtar për pranimin e aplikacioneve të përcaktuar me datë të saktë kalendarike; 1.8. dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikacionit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre; 1.9. mënyrën e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve; 1.10. mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët...”* 2. *Të gjitha shpalljet e konkurimit, gjithashtu, përmbajnë këto shënime: 2.1. “Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj”; 2.2. “Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”; 3. Kushtet për aplikim, në pajtim me paragrafin 1, nënparagrafin 1.2 të këtij neni, përfshijnë kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë në pajtim me nenin 8 të Ligjit dhe kërkesat e veçanta të pranimit në Grupin për të cilin zhvillohet konkurimi, të përcaktuara sipas dispozitave të Rregullores për klasifikimin e punëve në shërbimin*

civil. 4. Të gjitha dokumentet e dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e konkurimit, kandidati, përmes aplikacionit, vetdeklaracion se janë të vërteta dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e tyre. Deklarimi i rrejshëm paraqet shkak për përjashtimin nga procedura e pranimit. Neni 12 përcakton se: Përmbajtja e aplikacioneve 1. Aplikacioni përmbanë këto të dhëna: 1.1. një referencë në shpalljen e konkurimit; 1.2. të dhënat personale të kandidatit; 1.3. nivelin e arsimit si dhe diplomat e fituara, institucionet arsimore, datat e diplomimit; 1.4. një përshkrim të hollësishëm të përvojës së punës, duke përfshirë: emrin e punëdhënësit, funksionet, titujt, rangjet, kohëzgjatja e punës, një përshkrim i shkurtër i detyrave, numri dhe lloji i personelit nën mbikëqyrje, adresa e punëdhënësit, arsyet për largimin nga vendi i punës; 1.5. njohuritë gjuhësore; 1.6. informata mbi trajnimet e veçanta të kryera, kualifikimet profesionale dhe specializimet, aftësitë e veçanta dhe publikimet; 1.7. njohuritë kompjuterike; 1.8. emri, adresa dhe numri i kontaktit të dy (2) personave referues; 2. **Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurimit, kandidatët duhet të bashkangjitin edhe dokumentacionin si në vijim:** 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurimit dhe të deklaruara në aplikacion. Neni 14 përcakton se: Neni 14 Fazat e konkurrimit 1. Konkurimi për pranimin në shërbimin civil, përfshin dy faza: 1.1. Verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. Vlerësimi i kandidatëve. Neni 15 përcakton se: 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë. 4. Kandidatët të cilët plotësojnë kushtet për aplikim renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Lista shpallet në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 5. Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katermbëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 6. Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj.

Në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë, Kolegji i Këshillit ka analizuar Konkursin me numër reference RN00011612, për emrin e grupit Specialistë të Arsimit, titulli i vendit të punës "Inspektor i Arsimit", ku sipas pikës 3, si i kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: - **Arsimi:** Diplomë/ a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve; - **Licencë** e mësimdhënësit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës **Përvoja e punës:** Së paku dy vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës, me theks të veçantë, përvojë punë në mësimdhënie, ndërsa sipas pikës 7 të konkursit, dokumentacione për aplikim janë specifikuar: - Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimi për diplomat e marra jashtë vendit; - Kopje e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet se paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale; - Kopjet e dëshmisë së trajnimeve; - Certifikatë/vërteti nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të ciklën

dëshmohej se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit. - Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojë e kërkuar e punës, është në sektorit publik atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilën dëshmohej se ai/ajo nuk gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 8 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.6) të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Në këtë kuptim, Kolegji i Këshillit nga analizimi i dokumentacionit të aplikimit të ankuesit, i përcjell nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë, ka gjetur së ankuesi përkitazi me kriteret e përgjithshme formale dhe dokumentet e kërkuar sipas pikës 7 të konkursit, ka dorëzuar dëshmi lidhur me arsimin, përkatësisht Diplomën me numër 1813 të datës 30.06.2011, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, për përfundimin e Fakultetit Filozofik, Dega e Historisë, dhe ka marr titulli Profesor i Historisë. Lidhur me përvojën e punës ka prezantuar Kontratën e Punës me numër protokollit 185, të datës 22.09.2015, Vërtetimin Ref.nr.368/23 të datës 26.05.2023, nga i cili vërtetohet fakti së ankuesi është i punësuar në Shkollën e Mesme të Lartë SHML” Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec, në marrëdhënia të rregullt të punës nga data 01.09.2019, kontratë të përhershme, të cilën punë vazhdon ta ushtroj aktualisht dhe është i caktuar në vendin dhe detyrat e punës: mësimdhënës i gjeografisë dhe pasqyrën e Trustit Pensional për periudhën nga 19.05.2022 deri 19.05.2023 Lidhur me licencën e mësimdhënies, ka ofruar Licencën me numër 10008174 të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Me tej, sipas shkresave të lëndës rezultojnë së ankuesi ka ofruar: certifikatën mbi dënimet penale nr.serik:56E1EDFDBF11422, të datës 23.05.2023, të lëshuar Këshilla Gjyqësor i Kosovës, më të cilin vërtetohet së ankuesi nuk është i dënuar më aktgjykim të formës së prerë, si dhe dëshmi lidhur me trajnimet e përfunduar si: certifikatën nr.0207/002, për përfundimin e trajnimit me temën “Forcimi i Kapaciteteve për Udhëheqjen Efektive të Dialogut Social ” datë 26-29 nëntor 2015; Certifikatën e datës 01.07.2016, për pjesëmarrje në trajnimin me temën” Sigurimi i Cilësisë-Koordinator/e për Cilësi”; Certifikatën për përfundim të trajnimit për Kryetar të Aktiveve Profesionale për Sigurim të Cilësisë; Certifikatën, Prishtinë 2017, për pjesëmarrje dhe përfundimin e programit të trajnimit “ Vlerësimi i Performancës së Shkollës;” Certifikatën nr.1038/003, për përfundimin e trajnimit me temën “Udhëheqja dhe Planifikimi Strategjik në Arsimin Para universitar”; Certifikatën, shkurt 2020, për përfundimin e trajnimit me temën “Zhvillimi i Kapaciteteve në Udhëheqjen arsimor”, Certifikatën nr.133 për përfundimin e programit “ Marrëdhënia më Teknologjinë Informativë”; Certifikatën, nr.5643/005, për përfundimin e trajnimit me temën “ Edukimi Medial dhe Roli i Tij në Zhvillimin Shoqëror dhe Demokratik”; Certifikatën, nr.31665/073, për pjesëmarrje në trajnimin sipas programit “Mësimdhënia e bazuar në projekte”; Certifikatë për pjesëmarrje dhe përfundimin e programit të trajnimit të mësimdhënies në shërbim-Zhvillimi i Shkathësive të mësimdhënies për pilotimin e kurrikulës së re; Certifikatën, nr.32556/076 , për përfundimin e trajnimit sipas programit “Vlerësimi për të nxënë”; Certifikatë për pjesëmarrje në programin trajnues “ Mësimdhënia Online në Nivelin e Duhur”; Certifikatën dhjetor 2022, për pjesëmarrje dhe përfundimin e programit të trajnimit ”Planifikimi sipas nevoja të nxënësit (nxënës me nevoja të veçanta)“-Hartimi i planit Individual (PIA) për nxënës me AK”; Certifikatën për përfundimin e trajnimit “Menaxhimi i Klasës dhe Disiplina”; Certifikatën e datës 31.05.2021, për përfundim të kursit themelor ” Vlerësimin për Nxënie”; Certifikatën, Prishtinë 2018, për përfundimin e programit të trajnimit për trajner për fushën “ Shoqëria dhe Mjedisi në Zbatimin e Kurrikulës së Re”; Diplomën, e datës 19.12.2011, për përfundimin e programit “ Reconciliation Leadership Skills”; Certifikatën për përfundimin e kursit “Mësimdhënia më Nxënësit në Qendër”, Certifikatën, 13.02.2005, për pjesëmarrje në seminarin me temën “ Didaktika dhe Metodika për mësimdhënësit e shkollave të mesme profesionale”, Certifikatën, 29.09.2006, për pjesëmarrje dhe përfundimin e testit në Seminarin me temën

“Udhëheqja Arsimore”; Certifikatën, 25.12.2002, për përfundimin e Seminarit “ Edukimi i të Drejtave të Njeriut në Shkolla”; Certifikatën nr.6198/026, për pjesëmarrje në trajnimin sipas programit “ Strategjitë e Reja të Mësimdhënies dhe të Nxënit”; Certifikatën nr.6625/027, për pjesëmarrje në trajnimin sipas programit “Strategjitë për Krijimin e Lexuesve mendimtarë”, Certifikatën për përfundimin e kursit trajnues ”Trafikimi i Qenieve Njerëzore dhe Roli i Shkollës në Parandalimin e tij”; Certifikatë për pjesëmarrje në workshopin për trajnimin për trajner “Teaching Modern Southeast European History-Alternative Education Materials”.

Andaj, bazuar në vlerësimin e dëshmimeve si me sipër, rrjedhë së ankuesi ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale dhe njëkohësisht i njëjti ka ofruar tërë dokumentet e kërkuar sipas pikës 7 të konkursit, kështu që mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se njësia përgjegjëse-DMZP-ja, me rastin e nxjerrjes së vendimeve të goditura me ankesë përkatësisht Vendimit nr.14/2023 të datës 10.07.2023 dhe Vendimit Nr.15/2023 të datës 19.07.2023, nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, sepse ankuesi ka ofruar Vërtetimin Ref.nr.368/23 të datës 26.05.2023, nga përmbajtja e të cilit vërtetohet saktë së i njëjti është i punësuar në sektorin publik respektivisht në Shkollën e Mesme ”Xhelal Hajda-Toni”, në Rahovec, si profesor i lëndës së gjeografisë, dhe së i njëjti është duke u ushtruar këtë detyrë, që rrjedhimisht nënkupton së ankuesi nuk ka në fuqi ndonjë masë disiplinore për largim nga detyra e zyrtarit publik , kështu që, njësia përgjegjëse më rastin e mos përfshirjes së ankuesit në listën e ngushtë, për konkursin me numër reference RN00011612, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar si me lart, Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.1019/2023

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit ()
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.